

## Legjionaret/ Sadiku shenon nje tjeter gol ne Zvicer

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 19 Tetor 2013 21:58

---



Armando Sadiku nuk di te ndalet para portave kundertshtare. Sulmuesi shqiptar i harruar nga Xhani De Biazi ka shenuar nje tjeter gol ne Zvicer. 22 vjeçari ka realizuar ne minuten e 65-te per te barazuar rezultatin ne 2:2, por vetem nje minute me vone Lugano eshte ndeshkuar serish per te mos shmangur dot humbjen perballe Winterthurit. Ky ishte goli i dyte per Sadikun ne kete fillim sezoni per Luganon skuader te cilen pritet ta lere ne muajin janar.